



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 665/a Prot.

Tiranë, më 31/05 2013

URDHËR

Nr. 13 datë 31/05 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit gazeta online www.korcanews.com

KONSTATOVA

Pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është paraqitur një ankesë nga subjekti i të dhënave personale z. Arben Belba banues ne Korçë, me detyre Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Korçë, nëpërmjet së cilës ai pretendon se:

Kontrolluesi media elektronike www.korcanews.com, ka bërë publikimin e pa autorizuar të fotografisë së tij të karakterit personal privat, ka publikuar të dhënat personale të tij siç janë gjeneralitetet, emri mbiemri, pozicioni i punës, në një artikull i cili përmban informacion të rremë etj..

Subjekti i të dhënave personale z. Arben Belba në mbështetje të pretendimeve të tij në ankesë ka bashkëlidhur; një printim nga faqja www.korcanews.com, e datës 15/11/2012 ora 10.48 me shkrimin "Drejtoria Arsimore Korçë humbet të gjitha gjyqet me paditësit" të ilustruar me fotografi, si dhe një printim të dytë me shkrimin "MASH përzgjedh kandidatura për kreun e DAR Korçë" e ilustruar me fotografi, (në këtë printim nuk përmbahet logoja e faqes www.korcanews.com).

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës rezultoi i nevojshëm inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **media elektronike** www.korcanews.com, me qëllim;

- verifikimin e ankimit të subjektit të të dhënave personale z. Arben Belba, lidhur me publikimin e të dhënave personale të këtij subjekti prej kontrolluesit **media elektronike** www.korcanews.com,
- zbatimi i kushteve dhe kriterëve ligjore të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 i ndryshuar "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", udhëzimit nr. 9 datë 15/09/2010 "Për rregullat themelore ne lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale ne media e shkruar, vizive dhe audiovizive" dhe udhëzimit nr.31 datë 27/12/2012 "Përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për përjashtim nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie,letrare ose artistike" nga kontrolluesi **media**

elektronike www.korcanews.com, ne publikimin e këtij artikulli dhe në vijim të veprimtarisë së kësaj gazete elektronike.

Një grup i inspektimi i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbështetur nw urdhrin nr. 23 datë 07/02/2013 tw Komisionerit, ka zhvilluar inspektim administrativ pranë *media elektronike* www.korcanews.com dhe nga ky inspektim administrativ u konstatua se;

- Kontrolluesi media elektronike www.korcanews.com, është një gazetë “online” (jo me printim) e cila ka për kryeredaktor z. Erget Cenolli (gazetar), banues në adresën lagja 15, Rr. Kico Drenova, pall. Nr. 9, hyrja 2/15 dhe për administrator znj. Valbona Frost (motra e Erget Cenolli) me banim në Detroid, *SHBA (sipas intervistimit të bërë z. Ergert Cenolli)*
- Kontrolluesi www.korcanews.com, si një gazetë online nuk figuron e regjistruar si subjekt fizik apo si subjekt juridik. Aktivitetin e ushtron në një nga ambientet e shtëpisë së kryeredaktorit në adresën e mësipërme.
- Në momentin e inspektimit administrativ konstatohet se faja online e gazetës www.korcanews.com, nuk funksionon plotësisht. Nuk mund të kërkohet në arshivë për materialet e publikuara më parë dhe për këtë arsye nuk mundet që në prezencë të kontrolluesit të printohen të dy artikujt e publikuar.
- Të dy artikujt shkrimi i parë “*Drejtorja Arsimore Korçë humbet te gjitha gjyqet me paditësit*” dhe shkrimi i dyte me temë “*MASH për zgjedh kandidatura për kreun e DAR Korçë*”, janë shkruar nga kryeredaktori Erget Cenolli dhe janë publikuar i pari në gazetën online www.korcanews.com, dhe shkrimi i dytë në adresën personale në www.facebook.com (sipas intervistimit të bërë z. Ergert Cenolli)
- Të dhënat e materialit të shkruar dhe ilustrimi me foto janë mbledhur dhe realizuar nga burime personale për qëllime lajmi/gazetarie.

Nisur nga pretendimet në ankesën e subjektit të të dhënave personale, fakteve dhe konstatimeve të grumbulluara gjatë inspektimit administrativ pranë kontrolluesit gazetës online www.korcanews.com, vlerësojmë sa më poshtë:

Për sa i përket publikimit të pa autorizuar të fotos së ankuesit, si e dhenë personale e karakterit personal privat, si dhe të dhënave të tjera personale si emri, mbiemri pozicioni i punës i subjektit të të dhënave personale në dy artikujt “*Drejtorja Arsimore Korçë humbet te gjitha gjyqet me paditësit*” dhe “*MASH për zgjedh kandidatura për kreun e DAR Korçë*” na rezulton se:

- o Artikulli i parë “*Drejtorja Arsimore Korçë humbet te gjitha gjyqet me paditësit*”, është artikull i cili përbën lajm për publikun, në të shkruhet për Institucionin e Drejtorisë Rajonale Arsimore Korçë, në këtë lajm nuk përmenden privatësia e subjektit të të dhënave personale z. A. Belba (të dhënat personale të pretenduara nga subjekti si emri, mbiemri, pozicioni i punës, me përjashtim të të dhënës personale fotografi e ankuesit).

Vendosja ne artikull e fotografisë së ankuesit z. A. Belba (subjekt të të dhënave personale), pavarësisht se ajo rezulton të jetë marrë në një ambient publik, konsiderohet jo në përputhje me qëllimin e artikullit dhe më lajmin që përçon ky artikull, kjo foto nuk përcjell subjektin e të dhënave personale, ankuesin z. A. Belba si drejtues të Drejtorisë Rajonale Arsimore Korçë, por duket haptazi që është vendosur prej kontrolluesit me qëllim prishjen e imazhit në publik, pasi kjo foto nuk lidhet me pozicionin e punës së subjektit të të dhënave personale.

Lidhur me pavërtetësinë e lajmit të shkruar në artikullin “*Drejtorja Arsimore Korçë humbet te gjitha gjyqet me paditësit*”, pretendim i ankuesit z. A. Belba, rezulton se në artikull informacionet janë për Institucionin e Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë dhe jo për subjektin e të dhënave personale. Inspektimi administrativ nuk u zgjerua ne këtë pikë për faktin se edhe në rast të një lajmi të pavërtetë si shpifje etj, në adresë të vet subjektit të të dhënave personale, subjekti i këtyre të dhënave personale, duhet të mbrohet me mjete të tjera ligjore si drejtimi pranë organit të Prokurorisë së Rrethit për të bere kallëzim pasi këto sjellje parashikohen si vepra penale ne kodin penal.

Gjatë trajtimit të ankesës dhe në momentin e kryerjes së inspektimit administrativ rezulton që faqja e kontrolluesit *gazetës online* www.korcanews.com, nuk është në funksion të plotë dhe nuk bëhet i mundur të shihet artikulli së bashku me fotografinë e subjektit të të dhënave personale z. A. Belba, për më tepër të shihet nëse kontrolluesi i ka të ruajtura ato në arkivin e tij. I gjithë trajtimi i ankesës mbështetet në pretendimin e subjektit të të dhënave në ankesë, si dhe në pohimet e bërë gjatë zhvillimit të intervistës me gazetarin k/redaktor i *gazetës online* www.korcanews.com, z. Erget Cenolli.

- Sa i përket shkrimit të dytë në artikullin “*MASH për zgjedh kandidatura për kreun e DAR Korçë*” konstatohet se faqja e printuar e këtij artikulli nuk përmban logon e kontrolluesit *gazetës online* www.korcanews.com. Në intervistën e bërë nga grupi i inspektimit administrativ, gazetari k/redaktor i *gazetës online* www.korcanews.com, z. Erget Cenolli shprehet se këtë artikull nuk e ka publikuar në faqen e *gazetës online* www.korcanews.com, por në llogarinë e tij në www.facebook.com. Në kushtet kur faqja e *gazetës online* www.korcanews.com nuk është në funksion të plotë, inspektimi administrativ nuk mund të shtrihej më tej.

Sa më sipër nga gjithë trajtimi i ankesës dhe inspektimi administrativ i kryer pranë kontrolluesit *gazetës online* www.korcanews.com lidhur me ankesën e subjektit të të dhënave personale A. Belba vlerësoj se:

Publikimi i fotografisë së subjektit të të dhënave personale z. A. Belba në *gazetën online* www.korcanews.com, në artikullin “*Drejtorja Arsimore Korçë humbet te gjitha gjyqet me paditësit*”, konsiderohet jo në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, si dhe udhëzimet nr. 9 datë 15/09/2010 “*Për rregullat themelore ne lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale ne media e shkruar, vizive dhe autovizive*”, udhëzimin nr.31 datë 27/12/2012 “*Përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për përjashtim nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike*”, pasi është jo në përputhje me qëllimin e artikullit dhe më lajmin që përçon ky artikull, kjo foto nuk përcjell subjektin e të dhënave personale (ankuesin) si drejtues të Drejtorisë Rajonale Arsimore Korçë.

Nga inspektimi administrativ u konstatua se kontrolluesi *gazeta online* www.korcanews.com nuk ka njoftuar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, detyrim ligjor që rrjedh nga neni 21 i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, “*Përgjegjësia për të njoftuar*” *Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë*”.

Sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative :

URDHËROJ

1. Në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" udhëzimit nr. 9 datë 15/09/2010 "Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në media e shkruar, vizive dhe audiovizive" dhe Udhëzimin nr.31, datë 27/12/2012 "Për caktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtim nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike", kontrolluesi gazeta online www.korcanews.com të realizojë menjëherë fshirjen e fotografisë së subjektit të të dhënave personale Z. A. Belba nga artikulli i publikuar;
2. Kontrolluesi gazeta online www.korcanews.com, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" të plotësojë detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale brenda datës 15/06/2013.
3. Kontrolluesi gazeta online www.korcanews.com në aktivitetin e saj të respektojë ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Udhëzimin nr. 9 datë 15/09/2010 "Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në media e shkruar, vizive dhe audiovizive", si dhe Udhëzimin nr.31 datë 27/12/2012 "Për caktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtim nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike";
4. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
5. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit... Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".
6. Një kopje e urdhrit të njoftohet subjektit të të dhënave personale z. Arben Belba.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konc. H. Haxhillari
N. Sulaj
Sigloi. E. Karagjozi
Data. 28/05/2013

